

Raporti i Audituesit të Pavarur

Drejtuar: Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë të Përgjithshme të Pronësisë Industriale

Adresa: Bulevardi "Zhan Dark" Prona Nr.33, Godina e Ish Ushtarakëve, Tiranë

Opinionit

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Drejtorisë të Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI) më 31 dhjetor 2021, performancën e saj financiare, flukset monetare dhe fondet për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Udhëzimin nr.8 datë 09/03/2018 në Shqipëri.

Ne kemi audituar

Pasqyrat financiare të DPPI përfshijnë:

- Pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2021
- Pasqyrën e performancës për vitin e mbyllur më atë datë;
- Pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto për vitin e mbyllur më atë datë;
- Pasqyrën e flukseve monetare për vitin e mbyllur më atë datë; dhe
- Pasqyrat e tjera të cilat përfshijnë Investimet, Aktivet afatgjata, shënimet shpjeguese dhe punonjësit.

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen më tej në seksionin Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare të raportit tonë.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë.

Pavarësia

Ne jemi të pavarur nga DPPI në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionin e Kontabilistit (që përfshin edhe Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët ("kodi i BSNEK"). Ne kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin e BSNEK-së.

Informacione të tjera

Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera janë informacione që jepen në Raportin Treguesit kryesorë financiarë të DPPI për vitin 2021, i cili nuk është i përfshirë në pasqyrat financiare dhe në raportin tim të auditimit mbi këto pasqyra.

Opinionit im mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe unë nuk shpreh ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri mbi këto informacione. Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, unë kam përgjegjësinë të lexoj informacionet e tjera dhe të vlerësoj nëse këto informacione kanë inkoherencë materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që unë kam marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket që janë me anomali materiale. Nëse bazuar në punën e kryer, unë arrij në përfundimin se në këto informacione ka një anomali materiale, atëherë unë duhet të raportoj për këtë fakt.

Unë nuk kam asgjë për të raportuar

Eftali Qirjaqi
AUDITUES LIGJOR
Liçensë Nr. 11 Datë 11.01.2000,
NIPT K465260781
Lagje "Qemal Stafa", Rr. "Studenti", Shkodër
Mobile: +355692069434, +355692079434
Email: eliqirjaqi@yahoo.com



Përgjegjësitë e drejtimit në lidhje me pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Udhëzimin nr.8 datë 09/03/2018 në Shqipëri, dhe për kontrollet e brendshme, të cilat drejtimi i gjykon të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, qofshin ato për shkak të mashtrimit apo pasaktësive.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e DPPI për të kryer veprimtarinë në vijimësi, duke vënë në dispozicion informacione për çështjet që kanë të bëjnë me vijueshmërinë e aktivitetit, nëse është e zbatueshme, përveç rasteve kur drejtimi synon ta likujdojë DPPI apo të ndërpresë aktivitetin, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare në tërësi, nuk përmbajnë anomali materiale, qofshin ato për shkak të mashtrimit apo të pasaktësive, dhe të lëshojmë një raport auditimi, duke përfshirë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk jep garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë, në rast se ekziston, një anomali materiale. Anomali mund të vijë si rezultat i mashtrimit apo pasaktësive dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht apo të marra së bashku, ekziston një pritshmëri e arsyeshme që të kenë ndikim në vendimet ekonomike të marra nga përdoruesit në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Për më tepër, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalisë materiale në pasqyrat financiare, si rezultat i mashtrimit apo pasaktësisë, hartojmë dhe kryejmë procedura auditimi që i përgjigjen këtyre rreziqeve, si dhe sigurojmë të dhëna të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, në mënyrë që të shërbejnë si bazë për opinionin tonë. Rreziku për të mos identifikuar një anomali materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë sesa një anomali si rezultat i pasaktësisë, për shkak se mashtrimi mund të përfshijë një marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosveprim të qëllimshëm, shtrembërim, ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurojmë kuptueshmëri të kontrolleve të brendshme që mund të jenë të nevojshme për hartimin e procedurave të auditimit që u përshtaten rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrolleve të brendshme të DPPI.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël, si edhe shënimeve shpjeguese të përgatitura nga drejtimi.
- Arrijmë në një përfundim në lidhje me përshtatshmërinë e parimit kontabël të vijimësisë së veprimtarisë të përdorur nga drejtimi dhe, bazuar në evidencën e siguruar të auditimit, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të ngjallin dyshime të rëndësishme në lidhje me aftësinë e DPPI për të vijuar veprimtarinë. Në rast se arrijmë në përfundimin që ekziston një pasiguri materiale, jemi të detyruar që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të audituesit në lidhje me shënimeve shpjeguese të pasqyrave financiare ose, në rast se shënimeve shpjeguese nuk janë të përshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencën e auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë të audituesit. Pavarësisht kësaj, ngjarje apo kushte në të ardhmen, mund të shkaktojnë ndërprerjen e vijimësisë së veprimtarisë së DPPI.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë pasqyrat e tjera Investimet, Aktivet afatgjata, shënimeve shpjeguese dhe punonjësit dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet në mënyrë të atillë që sigurohet paraqitja e drejtë.

Ne komunikojmë me drejtimin, ndërmjet të tjerash, në lidhje me qëllimin dhe afatet e planifikuara të auditimit si dhe gjetjet e rëndësishme të konstatuara nga audituesi, përfshirë mangësitë e rëndësishme në sistemin e kontrolleve të brendshme që identifikojmë gjatë auditimit tonë.

Çështjet të tjera të Auditimit



Efektet e COVID – 19 të shkatuara në rang kombëtar dhe atë ndërkombëtar janë të mëdha, efekte të cilat vazhdojnë dhe gjatë vitit 2021. Si auditues kemi analizuar dhe diskutuar për vijimësinë e aktivitetit të DPPI me Drejtimin. Deklaratat e marra nga drejtimi, sigurojnë se aktiviteti i DPPI do të vazhdojë dhe vijimesia nuk do të çënohet.

Eftali QIRJAKI
Auditues Ligjor



Shkodër, më 28/03/2022